



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika **d** e Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika **d** e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2023, merr këtë

V E N D I M

1. **Miratohet** Plani i Integritetit në Kryeqytet për periudhën 2023-2026.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, Plani i Integritetit në Kryeqytet mundëson identifikimin e rreziqeve përkatëse të korrupsionit në fusha të ndryshme të punës në një organizatë individuale, vlerësimin e çfarëdo lloj rreziku që mund të paraqitet në shfaqjen e korrupsionit për një organizatë individuale, përcaktimin e masave për të zvogëluar ose eliminuar rreziqet e korrupsionit dhe për të maksimizuar transparencën dhe llogaridhënien.
3. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi, është Plani i Integritetit të Kryeqytetit për periudhën 2023-2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe drejtoritë tjera relevante.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-011/01-227546/23, më 01.12.2023

KRYESUES I KUVENDIT
Pëllumb Bajcinovci